

Kapiteni legjendar i Kombëtares së Shqipërisë, Lorik Cana, i është lutur Zotit që të jetë në anën e tyre nesër kur të përballen me Serbinë.

Lorik Cana thotë se Kombëtares shqiptare i nevojitet ta bëjë lojën më të mirë, për të arritur deri tek rezultati pozitiv ndaj Serbisë. Futbollisti kosovar e ka bërë një postim në rrjetin social, Facebook, përmes së cilit i ka motivuar bashkëlojtarët.

“Duhet me luajt ndeshje perfekte për të fituar nesër ndaj Serbisë. Edhe pse dihet që ata kanë një skuadër cilësore, duhet të luftojmë me gjithë forcat tona për gjithë kombin tonë dhe për nder të të parëve tanë kryelartë. Këtë e dinë gjithë çunat, këtë e di gjithë Kombëtarja, këtë e di një Shqipëri e tërë. Allahu qoftë me ne nesër!”, ka shkruar Cana.

[Post](#) by [Lorik Cana - Official](#).